

53.858.848€

ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës gjatë 7 muorit të parë të këtij viti në raport me periudhën e njëjte të vitit paraprak.

iSIGURIMET

Nr. #020 • Shtator 2020 • www.shs-ks.com

 # InsuranceAssociationofKosova

VETËM 13,523
POLICA U SHITEN
GJATË MUAJIT PRILL

06



NUMRI I KONTRATAVE
KA RËNË PËR
37,30%

07

26 MILIONË EURO DËME U PAGUAN PËR 7 MUAJ

Vetëm gjatë 7 muajve të parë të këtij viti, me gjithë problemet e shumta që janë shfaqur si pasojë e pandemisë COVID-19, por edhe numrit shumë të madh të automjeteve të paregjistruara të cilat janë duke shkaktuar aksidente në vazhdimësi, kompanitë e sigurimeve kanë arritur të paguajnë më shumë se 26 milionë euro dëme. Bazuar në të dhëna zyrtare shihet se trend i njëjtë i pagesës së dëmeve ka vazhduar edhe gjatë muajit gusht të këtij viti.

04

69,853

DËME JANË PAGUAR NGA
KOMPANITË E SIGURIMEVE
VETËM GJATË 7 MUAJVE TË
PARË TË KËTIJ VITI.

437 mijë euro dëme të paguara në sigurimin e jetës

Vetëm gjatë shtatë muajve të parë të këtij viti kompanitë për sigurimin e jetës kanë paguar dëme në vlerë prej 437 mijë euro. Shifër thuajse e njëjtë është kompensuar edhe në periudhën e njëjtë të vitit paraprak

iSIGURIME

Më shumë se 437 mijë euro dëmeve janë paguar vetëm gjatë 7 muajve të parë të këtij viti për sigurimin e jetës. Në bazë të të dhënave zyrtare të siguruar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), shihet se shifër thuajse e njëjtë është kompensuar edhe në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Për produktin Sigurimi i mbijetesës gjatë 7 muajve të parë të këtij viti janë paguar 37,712 euro. Gjithashtu, për produktin tjetër Jeta e debitorit gjatë shtatë muajve të parë të këtij viti në emër të kompensimit të dëmeve kompanitë e licencuara nga BQK-ja kanë paguar 77,834 euro, raporton “iSIGURIME”.

Më tutje në raportin e BQK-së shihet se për produktin Jeta e kombinuar gjatë kësaj periudhe kohore janë paguar dëme në vlerë prej 291,210 euro, për produktin tjetër Jeta në grup janë paguar dëme në vlerë prej 2,561 euro, si dhe për produktin tjetër Jetë me kursim për shtatë muajt e parë të këtij viti janë paguar 27,718 euro.

Duke u mbështetur në këto të dhëna shihet se gjatë kësaj periudhe kohore primet e shkruara në sigurimin e jetës kanë arritur në 2,087,616 euro e që është një rritje prej 2,4 për qind në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.



“DUKE U MBËSHTETUR NË KËTO TË DHËNA SHIHET SE GJATË KËSAJ PERIUDHE KOHORE PRIMET E SHKRUARA NË SIGURIMIN E JETËS KANË ARRITUR NË 2,087,616 EURO E QË ËSHTË NJË RRRITJE PREJ 2,4 PËR QIND NË RAPORT ME PERIUDHËN E NJËJTË TË VITIT TË KALUAR”, THUHET NË RAPORTIN E FUNDIT TË BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS

PRODUKTI	PRIMET E SHKRUARA	SHUMA E KOMPENSUAR
SIGURIMI I MBIJETESËS	/	37,712 EURO
JETA E DEBITORIT	471,303 EURO	77,834 EURO
JETA E KOMBINUAR	1,375,945 EURO	291,210 EURO
JETË NË GRUP	148,570 EURO	2,561 EURO
JETË ME KURSIM	37,199 EURO	27,718 EURO
JETA E STUDENTIT	39,520 EURO	/
TOTAL:	2, 087.616 EURO	437,036 EURO

9575 KONTRATA PËR SIGURIMIN E JETËS

JANË LIDHUR NË MES QYTETAREVE DHE KOMPANIVE TE LICENCUARA PËR KËTË PRODUKT NGA BQK-JA GJATË SHTATË MUAJVE TË PARË TË KËTIJ VITI

29,74 % ËSHTË RRRITUR NUMRI I KONTRATAVE PËR SIGURIMIN E JETËS GJATË SHTATË MUJORIT TË PARË TË KËTIJ VITI NË RAPORT ME PERIUDHËN E NJËJTE TË VITIT PARAPRAK.

167 ËSHTË NUMRI I DËMEVE TË KOMPENSUAR

NGA KOMPANITË E SIGURIMIT TË JETËS GJATË SHTATË MUAJVE TË PARË TË KËTIJ VITI

Vetëm 13,523 polica u shiten gjatë muajit prill

Sipas të dhënave të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), gjatë muajit prill të këtij viti shihet se të gjitha kompanitë e sigurimeve së bashku kanë shitur vetëm 13,523 polica obligative sigurimi. Krahësuar me të dhënat paraprake shihet qartë se ky është numri më i vogël i shitjes që nga viti 2003 e këndej

ISIGURIME

Vetëm 13,523 polica sigurimi obligative i kanë shitur të gjitha kompanitë e sigurimit gjatë muajit prill të këtij viti. Në bazë të të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës të cilat i ka siguruar “ISIGURIME” shihet qartë se ky është numri më i vogël i policave të shitura që nga viti 2003 e këndej. Duke iu referuar këtyre të dhënave shihet se gjatë muajit korrik të këtij viti të gjitha kompanitë e sigurimeve së bashku kanë shitur 36,192 polica sigurimi, që në raport me muajin paraprak ka një rënie prej 11,77 %. Gjatë muajit qershor të vitit 2020 kompanitë e sigurimeve kanë shitur 41,018 polica, apo 35,76 % më shumë krahasuar me muajin paraprak. Ndërsa gjatë muajit maj janë shitur 30,214 polica apo 123,43 % më shumë krahasuar me muajin paraprak. Gjithashtu gjatë muajit prill kompanitë e sigurimeve kanë shitur 13,523 polica obligative apo 22,28 % më pak në raport me muajin paraprak. Gjatë muajit mars janë shitur 17,400 polica apo 42 % më pak në raport me muajin paraprak, gjatë muajit shkurt 2020 janë shitur 30,002 polica apo 18,65 % më shumë se sa në muajin janar, si dhe gjatë muajit janar 2020 janë shitur 25,287 polica, apo 11,94 % më pak se sa në muajin paraprak, pra dhjetor 2019.



“GJATË MUAJIT KORRIK TË KËTIJ VITI TË GJITHA KOMPANITË E SIGURIMEVE SË BASHKU KANË SHITUR 36,192 POLICA SIGURIMI, E KU NË RAPORT ME MUAJIN PARAPRAK KA NJË RËNIE PREJ 11,77 %. GJATË MUAJIT QERSHOR 2020 KOMPANITË E SIGURIMEVE KANË SHITUR 41,018 POLICA, APO 35,76 % MË SHUMË, KRAHASUAR ME MUAJIN PARAPRAK. GJATË MUAJIT MAJ JANË SHITUR 30,214 POLICA APO 123,43 % MË SHUMË KRAHASUAR ME MUAJIN PARAPRAK. GJITHASHTU GJATË MUAJIT PRILL KOMPANITË E SIGURIMEVE KANË SHITUR 13,523 POLICA OBLIGATIVE APO 22,28 % MË PAK NË RAPORT ME MUAJIN PARAPRAK, GJATË MUAJIT MARS JANË SHITUR 17,400 POLICA APO 42 % MË PAK NË RAPORT ME MUAJIN PARAPRAK, GJATË MUAJIT SHKURT 2020 JANË SHITUR 30,002 POLICA APO 18,65 % MË SHUMË SE SA NË MUAJIN JANAR, SI DHE GJATË MUAJIT JANAR 2020 JANË SHITUR 25,287 POLICA, APO 11,94 % MË PAK SE SA NË MUAJIN PARAPRAK, PRA DHJETOR 2019”.

MUAJI	NR.KONT.	KRAHASIMI	VLERA E PRIMEVE	KRAHASIMI
Korrik 2020	36,192	-11,77 %	5,292,174 €	14,34 %
Qershor 2020	41,018	35,76 %	6,178,103	37.82 %
Maj 2020	30,214	123,43 %	4,482,600 €	123,94 %
Prill 2020	13,523	-22,28 %	2,001,706	-25,66 %
Mars 2020	17,400	-42,00 %	2,692,696 €	-36,75 %
Shkurt 2020	30,002	18,65 %	4,257,244 €	13,52 %
Janar 2020	25,287	-11,94 %	3,750,318 €	-13,21 %
Dhjetor 2019	28,717	0,15 %	4,320,998 €	14,74 %
Nëntor 2019	28,673	-5,67%	3,765,833 €	-1,66%
Tetor 2019	30,396	6.65 %	3,829,364 €	4,72 %
Shtator 2019	28,501	-16,18 %	3,656,900 €	-12,28 %
Gusht 2019	34,004	-11,45 %	4,194,434 €	-12,65 %
Korrik 2019	38,399	30,99 %	4,801,743 €	27,82 %
Qershor 2019	29,315	-8,26 %	3,756,695 €	-11,45 %
Maj 2019	31,955	2,15 %	4,242,593	-0,78 %
Prill 2019	31,283	9,87 %	4,275,992 €	9,12 %
Mars 2019	28,474	26,20 %	3,918,662 €	29,04 %
Shkurt 2019	22,562	-4,84 %	3,036,752	3,23 %
Janar 2019	23,710	-14,36 %	2,941,691	-14,88 %

26 milionë euro dëme u paguan për 7 muaj

Vetëm gjatë 7 muajve të parë të këtij viti, me gjithë problemet e shumta që janë shfaqur si pasojë e pandemisë COVID-19, por edhe numrit shumë të madh të automjeteve të peregjistruara të cilat janë duke shkaktuar aksidente në vazhdimësi, kompanitë e sigurimeve kanë arritur të paguajnë më shumë se 26 milionë euro dëme. Bazuar në të dhëna zyrtare shihet se trend i njëjtë i pagesës së dëmeve ka vazhduar edhe gjatë muajit gusht të këtij viti.

iSIGURIME

Shuma e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve në Kosovë arrin vlerën prej më shumë se 26 milionë euro vetëm gjatë shtatë muajve të parë të këtij viti, me gjithë problemet e shumta që janë shfaqur si pasojë e pandemisë COVID-19, kur për një kohë të gjatë kompanitë e sigurimeve kanë punuar me orar e staf të reduktuar, por edhe numrit shumë të madh të automjeteve të peregjistruara, e të cilat janë duke shkaktuar aksidente në vazhdimësi, kompanitë e sigurimeve.

Bazuar në të dhënat zyrtare të siguruar nga Banka Qendrore e Kosovës shihet se shumta e mjeteve që kanë paguar të gjitha kompanitë e sigurimeve në Kosovë është sa gjysma e të hyrave të përgjithshme që ato kanë inkasuar gjatë 7 muajve të parë të këtij viti.

Po sipas këtyre të dhënave shihet se deri në fund të muajit qershor 2020 janë paguar gjithsej 25.842,294 euro dëme, derisa gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak të gjitha kompanitë kishin 26.881,589 euro, e gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018 shumta e mjeteve të paguara në emër të dëmeve kishte arritur në 20.834,757 euro, raporton "iSIGURIME".

MAZREKU: PAGESAT PO KRYHEN NË KOHË REKORDE

Në anën tjetër, drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës Sami Mazreku, thotë se pagesat e dëmeve nga kompanitë e sigurimeve po kryhen në kohë rekorde. Ai më tutje tregon

se të gjitha kompanitë e sigurimeve që janë të licencuara në Kosovë prioritet të vetëm e kanë pagesën e shpejtë të dëmeve për qytetarët. "Siç e kam thënë edhe në të kaluarën, prioritet i secilës kompani të sigurimit është pagesa e shpejtë dhe korrekte e dëmit. Është shumë me rëndësi të ceket se kompanitë e sigurimeve në Kosovës kanë paguar miliona euro edhe në kohën e pandemisë, kur ato thuajse nuk kanë inkasuar prim fare. Shumë milionë u paguan në kohë krize, por edhe më tutje po vazhdojnë të paguhen pavarësisht shumë problemeve që janë shfaqur në këtë kohë" ka thënë Mazreku. Sipas drejtorit Mazreku edhe më tutje problem serioz për Institucionet por edhe kompanitë e sigurimeve në Kosovë përbën numri shumë i madh i automjeteve të peregjistruara, që sipas tij së paku deri më tash nuk ka pasur gatishmëri institucionale për t'i trajtuar ato. "Shoqata e Sigurimeve të Kosovës mirëpret iniciativën e Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), për trajtimin e automjeteve të peregjistruara në vendin tonë. Shoqata e Sigurimeve, e përkrahur edhe nga guvernatori i BQK-së Fehmi Mehmeti, në vazhdimësi e ka ngritur problemin e automjeteve të peregjistruara, të cilat u sjellin dëme të mëdha si kompanive të sigurimit, ashtu edhe institucioneve të Kosovës", ka thënë më tutje drejtori Mazreku. Ai vlerëson se ulja sa më e shpejtë e numrit të automjeteve të peregjistruara ndihmon drejtpërdrejt edhe në anëtarësimin e Kosovës në Byronë e Kartonit të Gjellbër.

DËMET E PAGUARA PËR ÇDO MUAJ

Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë muajit korrik të këtij viti kompanitë e sigurimeve kanë paguar dëme në vlerë prej mbi 4,8 milionë euro. Ndërsa në muajt paraprak të këtij viti vlera e dëmeve dallon nga muaji në muaj, gjatë qershorit në emër të dëmeve kompanitë e sigurimeve kanë paguar 3,8 milionë euro, gjatë majit janë paguar 1,4 milionë euro, në prill janë paguar 3,1 milionë euro, në mars 3,1 milionë euro, në shkurt 4,1 milionë euro, si dhe në muajin janar shumta e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve ishte 5,5 milionë euro, apo gati 100 % më e lartë se sa ishte në muajin e njëjtë në vitin paraprak.

Dëmet e paguara nga viti 2000 e deri më tash Bazuar në të dhënat zyrtare të BQK-së të cilat i ka siguruar "iSIGURIME", shihet se nga viti 2000 e deri më tash kompanitë e sigurimeve kanë paguar hiç më pak se 500 milionë euro dëme. Duke u mbështetur në këto të dhëna





shihet se gjatë 6 muajorit të parë të këtij viti nga kompanitë e sigurimeve janë paguar 21 milionë euro, gjatë vitit 2019 janë paguar 50 milionë euro, gjatë vitit 2018 janë paguar 42,7 milionë euro, gjatë vitit 2017 janë paguar 42,1 milionë euro, gjatë vitit 2016 janë paguar 36,5 milionë euro, gjatë vitit 2015 janë paguar 37 milionë euro, gjatë vitit 2014 janë paguar 31.1 milionë euro. Po ashtu, në vitin 2013 janë paguar 38,4 milionë euro, në vitin 2012 janë paguar 30,5 milionë euro, në vitin 2011 janë paguar 26,8 milionë euro, në vitin 2010 janë paguar 26,5 milionë euro, në vitin 2009 janë paguar 18,8 milionë euro, në vitin 2008 janë paguar 17,7 milionë euro, në vitin 2007 janë paguar 12,8 milionë euro, në vitin 2006 janë paguar 10,9 milionë euro, në vitin 2005 janë paguar 9,1 milionë euro, në vitin 2004 janë paguar 6,7 milionë euro, në vitin 2003 janë paguar 5,5 milionë euro, në vitin 2002 janë paguar 3,5 milionë euro si dhe në vitin 2000 janë paguar 2,6 milionë euro dëme.

VITI	PAGESA E DËMEVE	TË HYRAT TOTALE
2020 (1-7)	25.842,294 €	53.670,044€
2019	49.977,495 €	97.999,080 €
2018	42.766,736 €	90.503,664 €
2017	42.151,078 €	84.919,344 €
2016	36.871,506 €	81.235,523 €
2015	36.971,397 €	78.767,663 €
2014	31.182,207 €	80.080,181 €
2013	38.448,821 €	77.385,883 €
2012	30.581,215 €	81.534,352 €
2011	26.812,984 €	78.095,611 €
2010	26.527,830 €	71.243,658 €
2009	18.834,757 €	67.756,310 €
2008	17.678,577 €	56.380,959 €
2007	12.821,635 €	50.811,083 €
2006	10.932,644 €	34.705,304 €
2005	9.165,533 €	47.212,598 €
2004	6.743,000 €	39.090,000 €
2003	5.583,705 €	37.060,000 €
2002	3.540,000 €	27.231,000 €
2001	/	/
2000	2.655,000	31.161,000 €

Numri i kontratave ka rënë për 37,30%

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) gjatë periudhës janar - korrik 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, numri i kontratave në sigurimin e jo jetës ka rënë për 37,30 %. Kjo rënie e shitjes si pasoje e pandemisë COVID-19 është më e madhja që nga konsolidimi i sektorit të sigurimeve e deri më tash.

iSIGURIME

Gjatë shtatë muajve të parë të këtij viti numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës arriti në 429.144, duke shënuar rënie në masën 37.30% më pak se në periudhën e njëjtë janar-korrik të vitit 2019. Bazuar në të dhëna zyrtare të BQK-së shihet se kjo është rënia më e madhe e shitjes që nga konsolidimi i sektorit të sigurimeve e deri më tash. Rënia e madhe e shitjes ka ndodhur si pasojë e pandemisë COVID-19, pasi që për një kohë jo të shkurtër kompanitë e sigurimeve kishim punuar me orar të limituar, derisa gjatë kësaj periudhe kohore Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve nuk kishin ofruar shërbim fare.

438,719

KONTRATA JANË LIDHUR NË MES TË KOMPANIVE TË SIGURIMEVE DHE QYTETARËVE GJATË 7 MUAJVE TË PARË TË KËTIJ VITI.

TREGU KA RËNË PËR 5,9%

Gjatë periudhës janar - korrik 2020 tregu i sigurimeve ka pasur rënie prej 5.90% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Duke iu referuar të dhënave zyrtare të BQK-së, shihet se volumi i primeve të shkruara bruto në krahasim me periudhën paraprake është zvogëluar me 3,510,243 euro më pak, duke arritur shumën prej 55,946,465 euro.

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se numri i kontratave arriti në 438,719, duke shënuar një rënie me 36.59% krahasuar me periudhën e njëjtë janar - korrik 2019. Gjithashtu edhe volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës arriti shumën 53,858,848 euro, duke shënuar një rënie në masën prej 6.19% më pak krahasuar me periudhën janar - korrik 2019. “Numri i kontratave në sigurimin e

Jo-Jetës arriti në 429,144, duke shënuar një rënie në masën 37.30% më pak krahasuar me periudhën e njëjtë janar - korrik 2019”, thuhet në të dhënat e fundit të BQK-së, raporton “iSIGURIME”.

RRITET TREGU I SIGURIMEVE TË JETËS

Po sipas të dhënave zyrtare të BQK-së, shihet se volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës arriti shumën 2,087,617 euro, duke shënuar rritje në masën 2.04% krahasuar me periudhën e njëjte janar - korrik 2019. “Numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në 9,575, duke shënuar një rritje në masën 29.74% me shumë krahasuar me periudhën e njëjtë janar - korrik 2019”, thuhet më tutje në raport. Sipas këtij raporti, gjatë periudhës janar - korrik 2020 janë paguar gjithsej 27,020,857 euro dëme ose 2.14% më pak se gjatë periudhës së njëjtë janar - korrik 2019. “Numri i dëmeve të paguara gjatë periudhës janar - korrik 2020 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është zvogëluar me 8,383 më pak

2,087,617€

KA ARRITUR NË FUND TË MUAJIT KORRIK TË VITIT QË LAMË PAS VOLUMI I PRIMEVE TË SHKRUARA BRUTO NË VEPRIMTARINË E JETËS



6.19%

KA RËNË VOLUMI I PRIMEVE TË SHKRUARA BRUTO NË VEPRIMTARINË E JO-JETËS GJATË 7 MUJORIT TË PARË TË KËTIJ VITI NË RAPORT ME PERIUDHËN E NJËJTË TË VITIT PARAPRAK.



“NUMRI I DËMEVE TË PAGUARA GJATË PERIUDHËS JANAR - KORRIK 2020, NË KRAHASIM ME PERIUDHËN E NJËJTË TË VITIT PARAPRAK, ËSHTË ZVOGËLUAR ME 8,383 MË PAK DHE ARRITI NË 69,853 NGA TË CILAT 69,686 EURO DËME JANË PAGUAR NGA KOMPANITË E SIGURIMIT TË JO-JETËS DHE 167 NGA KOMPANITË E SIGURIMIT TË JETËS”, THUHET NË RAPORTIN E BQK-SË.

53,858,848€

KA ARRITUR VOLUMI I PRIMEVE TË SHKRUARA BRUTO NË VEPRIMTARINË E JO-JETËS GJATË 7 MUJORIT TË PARË TË KËTIJ VITI NË RAPORT ME PERIUDHËN E NJËJTË TË VITIT PARAPRAK.

dhe arriti në 69,853 nga të cilat 69,686 dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 167 nga kompanitë e sigurimit të Jetës”.

4,9 MILIONË EURO PROFIT

Ulja e madhe e shpenzimeve, por edhe aplikimi i tarifave të reja të aprovuara nga Banka Qendrore e Kosovës ka ndikuar që gjatë shtatë mujorit të parë të këtij viti sektorit i sigurimeve në vend të përformojë me bilanc pozitiv. Sipas të dhënave të fundit të BQK-së shihet se të gjitha kompanitë e sigurimeve në vend gjatë shtatë muajve të parë të këtij viti kanë siguruar një profit neto prej 4,9 milionë euro.

69,853

DËME JANË PAGUAR NGA KOMPANITË E SIGURIMEVE VETËM GJATË 7 MUJAVE TË PARË TË KËTIJ VITI.



Departamenti Amerikan i Shtetit vlerëson lart sektorin financiar në Kosovë

Departamenti Amerikan i Shtetit ka publikuar raportin për klimën e investimeve në Kosovë për vitin 2020, ku është dhënë vlerësim i lartë për sistemin financiar të vendit. Raporti thekson faktin se Kosova ka një ekonomi të tregut të hapur dhe tregu përcakton normat e interesit. Aty theksohet se sistemi rregullator përputhet me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, nuk ka kufizime përtej kërkesave normale rregullatore në lidhje me burimin e kapitalit, përshtatshmërinë dhe aftësinë e investitorëve dhe se BQK-ja ka marrë të gjitha masat e kërkuara për të përmirësuar politikat për rrjedhën e lirë të burimeve financiare. Në raport është theksuar edhe qëndrueshmëria e sektorit bankar, i cili mbetet mirë i kapitalizuar dhe fitimprurës. Kushtet e vështira ekonomike, zbatimi i dobët i kontratës dhe sjellja e paqartë ndaj rreziqeve kanë kufizuar aktivitetet e huazimit të bankave, megjithëse përmirësimi i dukshëm ndodhi në vitet e fundit. Në shkurt të vitit 2020, norma e kredive joperformuese ishte 2.5 përqind, niveli më i ulët në dhjetë vitet e fundit. Normat e interesit kanë rënë ndjeshëm në vitet e fundit, nga një mesatare prej rreth 12.7 përqind në vitin 2012, në një mesatare prej 6.3 përqind në vitin 2020. Kreditimi më i ngadaltë është i dukshëm në pjesën veriore të Kosovës për shkak të një gjyqësori të dobët, aktivitetëve informale të biznesit dhe më pak të kualifikuar huamarrësit. BQK-ja është përgjegjëse për nxitjen e zhvillimit të praktikave konkurruese, të shëndosha dhe transpar-



ente në sektorin bankar dhe financiar. BQK-ja mbikëqyr dhe rregullon sektorin bankar të Kosovës, industrinë e sigurimeve, fondet e pensionit dhe institucionet mikrofinanciare. BQK-ja gjithashtu kryen detyra të tjera standarde të bankës qendrore, duke përfshirë administrimin e parave të gatshme, transferimet, pastrimin, menaxhimin e fondeve të depozituara nga Ministria e Financave dhe institucione të tjera publike, mbledhjen e të dhënave financiare dhe menaxhimin e Regjistratit të Kredive. Raporti thekson se bankat dhe degët e huaja mund të kryejnë operacione në vend, duke iu nënshtuar të njëjtave kërkesa dhe rregullore licencimi si bankat vendase. Vendi nuk ka humbur asnjë marrëdhënie bankare korrespondente në tre

vitet e fundit dhe asnjë marrëdhënie e tillë aktualisht nuk është në rrezik. Nuk ka kufizime në hapjen e llogarive bankare nga të huajt, ata mund ta bëjnë këtë me dorëzimin e dokumentacionit të vlefshëm të identifikimit. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës shpreh vlerësimin më të lartë për raportin që ka të bëjë me pjesën e sektorit financiar dhe shpreh falënderimin më të sinqertë për Departamentin Amerikan të Shtetit për vlerësimin real të sektorit financiar në Kosovë dhe Ambasadën Amerikane në Kosovë, për përkrahjen e vazhdueshme që i ka dhënë që nga fillimi, dhe vazhdon t'i japë BQK-së në zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori.


Mbahet trajnimi teknik për ndryshimet ligjore në ligjin për korporatat

Shoqata e Sigurimeve të Kosovës ka organizuar trajnim dy ditor me departamentet e financave të kompanive të sigurimit, me temën "Trajnim teknik për ndryshimet ligjore në ligjin për korporatat". Ky trajnim kësaj radhe është organizuar në bashkëpunim me "Deloitte". Drejtori i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës Sami Mazreku thotë se organizimi i trajnimeve në të gjitha departamentet ka për qëllim të vetëm përgatitjen sa më profesionale të stafit i cili është pjesë e industrisë së sigurimeve të Kosovës.



Shoqata ia dorëzoi certifikatën Blerta Lekut

Koordinatori i Trajnimeve i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Ilir Prapashtica, ka dorëzuar certifikatat e edukimit të vazhdueshëm për ndërmjetësuesit e sigurimeve tek Blerta Leku, pranë TEB Bank.



Rexhepi pranon certifikatën e edukimit të vazhdueshëm

Koordinatori i Trajnimeve i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, Ilir Prapashtica, ka dorëzuar certifikatat e edukimit të vazhdueshëm për ndërmjetësuesit e sigurimeve të Bekim Rexhepi, pranë Fersig. Shoqata e Sigurimeve të Kosovës ofron shërbimin e trajnimeve për licencim dhe edukim të vazhdueshëm për ndërmjetësuesit në sigurime, në bazë të rregulloreve në fuqi të miratuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Njëkohësisht, është bërë edhe dorëzimi i ID-ve përmes të cilave Banka Qendrore e Kosovës, klientët dhe palët tjera do të kenë mundësinë e identifikimit sa më të lehtë të stafit të anëtarëve të Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës, të cilët janë të licencuar për ndërmjetësimin në sigurime dhe shitjen e produkteve të sigurimit.